

Të qenit prind

Edukimi i një fëmijë nuk është i lehtë. Ndoshta pyesni veten ndonjëherë, çka është e mirë për fëmijën tuaj. Mund të jetë shumë e dobishme të shkëmbeni mendime me prindër të tjerë. Përveç kësaj, qendra të ndryshme këshilluese mund t'ju ndihmojnë.

Pikëtakimet

Ka oferta të shumta për nëna dha baballarë. Këtu mund të bisedoni me prindër të tjerë ose të bëni aktivitete me fëmijën tuaj.

- Grupet e zvarritjes (Krabelgruppen) janë për foshnja dhe fëmijë të vegjël deri në 2 vjeç. Këtu mund të njiheni me prindër të tjerë.
- Gjymnastika prindër-fëmijë (gjymnastika nënë-fëmijë, gjymnastika baba-fëmijë ose gjymnastika prindër-fëmijë) është për prindër me fëmijë të vegjël. Ata mund të luajnë së bashku, të lëvizin dhe të kënaqen. Shumica e komunave ofron këtë lloj gjymnastike.
- Pikat e takimit në lagje (Quartiertreffpunkte) kanë ngjarje të ndryshme për prindër dhe fëmijë..
- Bibliotekat dhe ludotekat kanë oferta për fëmijë të vegjël dhe të mëdhenj dhe për prindërit e tyre.

Arsimimi për prindër

Në Basel-Stadt ka kurse për prindër rreth temave të ndryshme. Ka edhe kurse të posaçme për migrante dhe migrantë. Kështu ka shembull kurse për sistemin shkollor zviceran. Disa kurse janë edhe në gjuhë të tjera.

Këshillimi për edukim

Kur keni pyetje për edukimin e fëmijëve tuaj, këshillimore të ndryshme ndihmojnë. Kur për shembull keni bebe dhe fëmijë të vegjël deri në moshën 5 vjeç, ju mund të shkoni te këshillimi i prindërve (Elternberatung).

Për raste urgjente ekziston numri emergjent për prindërit. Këtu merrni këshillime nga specialistët. Kur merrni në telefon, ju paguani tarifën normale të telefonit fiks. Telefoni: 0848 35 45 55. Ose ju shkruani një e-mail. Adresa gjendet në www.elternnotruf.ch.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/me-qene-prind